

REPUBLIKA E KOSOVËS

Shifra,0599,RI.nr.17101/2011

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË FERIZAJ,në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Mehmet Tahiri nga fsh.Balaj,për shkak të kundërvajtjes nga neni 16.1.1 të Ligjit për deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lart publik,e në bazë të neneve 31,73 dhe 195 të Ligjit mbi kundërvajtjet,më 05.10.2011,muarr këtë:

AKTVENDIM

I pandehuri Mehmet Hajriz Tahiri,i lindur me dt.12.10.1952 në fsh.Balaj K Ferizaj ku dhe tani jeton ,me profesion mjek – pediatër.

ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

sepse si zyrtar i lartë – drejtor i departamentit të diagnostikës në spitalin e Ferizajt,brenda afatit të përcaktuar ligjor gjegjësisht gjer me dt.31.03.2011 ,nuk ka deklaruar pasurinë e tij tek agjencioni kundër korrupsionit në Prishtinë.

-me çka ka bërë kundërvajtje nga neni 16.1.1 të Ligjit për deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lart publik
-andaj në bazë të dispozitave të theksuara ligjore,

D E N O H E T

ME DENIM NË TË HOLLA,në shumën prej 300 €.

Denimin e shqipëtuor në të holla ka për ta paguar në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktvendimi,në të kundërtën denimi i tillë në të holla do të zëvendësohet me denim burgu në kohëzgjatje prej 20 ditësh.

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve paushalle të paguaj shumën prej 5 €,në afatin e njëjtë sikurse edhe denimin në të holla,nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.

Nga një ekzemplarë i aktvendimit u dërgohet palëve.

A r s y e t i m

Agjencia kundër korrupsionit në Prishtinë,paraqiti kërkesën për fillimin e procedurës kundërvajtëse nr.01-3246/2011,të dt.12.07.2011,kundër të pandehurit për shkak të kundërvajtjes së përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi dhe propozoj që i pandehuri të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjyqtari filloi procedurën kundërvajtëse, muarr në pyetje të pandehurin,i cili në deklaratën e tij në tërësi pranoi veprën kundërvajtëse të ngarkuar si në dispozitiv të këtij aktvendim ,duke shtuar se unë kam qenë i njoftuar nga agjencioni kundër korrupsionit në Prishtinë për të bërë plotësimin e formularit për deklarim të pasurisë dhe përkundër asaj që pata plotësuar formularin në fjalë dhe ate para afatit për dorëzim atë nuk kam arritur ta dorëzoj pasi që mu kishte ngatërruar dikund,e pastaj e kam lënë në asgjë e jo që e kam bërë qëllimisht këtë mos deklarim dhe më tej shtoi se për këtë e ndiej veten përgjegjës dhe herave tjera sa i përket kësaj çështje do të jem shumë më i kujdesshëm.

Në bazë të kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse, deklaratës së të pandehurit, shkresave tjera të lëndës,gjyqtari konstatoi se i pandehuri me veprimet e tij ka bërë vepër kundërvajtëse të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi për çka dhe u shpall fajtor dhe u denua siç u cek më lart.

Gjatë matjes së denimit është marrë parasysh pesha e kundërvajtjes dhe pasojat e saja , rrethanat nën të cilat është kryer kundërvajtja, gjendja ekonomike e të pandehurit,anda ju shpallua një denim i tillë në të holla, me bindje se edhe me këtë lloj denimi do të arrihet qëllimi ndëshkues.

Vendosur në Gjykatën komunale për kundërvajtje në Ferizaj, më datën 05.10.2011.

Proqesmbajtësja,
Kimete Bytyqi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër të këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e lartë për kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, nëpërmes të kësaj gjykate, pa pagesë takse.

